



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 237, datë 25.11.2019

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E  
KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË PROKURORISË SË POSAÇME**

Bazuar në nenin 148/dh pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenin 189 të ligjit “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” si dhe të neneve 18,19,20 të rregullores me objekt “Rregullore mbi Kriteret dhe Procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin e kandidatëve për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETAR

GENT IBRAHIMI



# **METODOLOGJI ORIENTUESE PËR VLERËSIMIN E KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË PROKURORISË SË POSAÇME**

## **I**

### **Hyrje**

Kjo Metodologji është një dokument i brendshëm pune i Këshillit të Lartë të Prokurorisë që synon të orientojë anëtarët në vlerësimin e kandidatëve për drejtues të Prokurorisë së Posaçme.

Vlerësimi i kandidatëve për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme bëhet duke u bazuar në procedurën dhe standardet e përcaktuara në nenet 18, 19 dhe 20 të Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe në një sistem pikëzimi të parashikuar në këtë metodologji.

Bazuar në rregullore, kandidatët për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme do të vlerësohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për sa më poshtë:

1. Eksperiencën në ndjekjen e çështjeve sensitive të korrupsionit dhe krimit të organizuar
2. Eksperiencën dhe aftësitë në organizimin dhe drejtimin e një strukture
3. Eksperiencën në hartimin dhe miratimin e rregulloreve administrative
4. Eksperiencën në çështje të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike dhe ndërveprim me median
5. Aftësitë në drejtimin efektiv të burimeve njerëzore
6. Vizionin ose planin e besueshëm për ndërtimin e Prokurorisë së Posaçme si një institucion funksional dhe efektiv
7. Imazhin publik të karrierës së tij/saj si prokuror

Kjo Metodologji parashikon mënyrën e vlerësimit të standardeve të mësipërme për të mundësuar një gjykim objektiv nga ana e anëtarëve të Këshillit në lidhje me plotësimin e secilit standard nga kandidatët për drejtues të Prokurorisë së Posaçme.

## **II**

### **Dokumentacioni që u kërkohet kandidatëve dhe mënyra e administrimit të tyre**

Për vlerësimin sipas standardeve të përcaktuara në nenin 19 të Rregullores, kandidatët dorëzojnë pranë Këshillit letrën e motivimit sipas nenit 18 të rregullores.

Gjithashtu kandidatët dorëzojnë gjithë dokumentacionin që vlerësojnë të nevojshëm për të dëshmuar plotësimin e këtyre standardeve. Përfshihen në këtë rast, akte të çështjeve penale të cilat janë vlerësuar në fazën e parë, atë të përzgjedhjes si prokurorë në Prokurorinë e Posaçme.

Për të bërë të mundur vlerësimin e standardeve sipas nenit 19 të Rregullores, kandidatët dorëzojnë një material shpjegues për secilin kriter (6 të tillë në total), jo me shume se 1 faqe A4, duke përjashtuar kriterin mbi vizionin i cili paraqitet në një dokument jo më shumë se 5 faqe. Materiali shpjegues për secilin kriter paraqet listën e dokumentave që paraqiten për vlerësim, sqarime se si dokumenti mbështetës tregon aftësinë e kandidatit për të performuar me sukses në rolin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Nëse kandidati nuk dorëzon asnjë dokument mbështetës, ai merr 0 pikë për atë kriter. Dokumentacioni administrohet nga të gjithë anëtarët e Këshillit për të realizuar vlerësimin dhe votimin.

### **III Standardet e vlerësimit**

#### ***Standardi 1***

##### ***Eksperiencia në ndjekjen e çështjeve sensitive të korrupsionit dhe krimin të organizuar (vlerësimi 0-3 pikë)***

Lidhur me këtë standard anëtarët e Këshilli vlerësojnë shpjegimet e kandidatëve në letrën mbështetëse si dhe shfrytëzojnë vlerësimet për kandidatët në fazën e parë, atë të përzgjedhjes si prokurorë të Prokurorisë së Posaçme.

#### ***Standardi 2***

##### ***Eksperiencia dhe aftësitë në organizimin dhe drejtimin e një strukture (vlerësimi 0-3 pikë)***

Ky standard duhet të dokumentohet nga ana e kandidatëve dhe duhet të dëshmohet nëpërmjet rezultateve të arritura në drejtimin dhe organizimin e një strukture. Këshilli vlerëson në raport me këtë standard:

- Eksperiencën drejtuese e vendimmarrëse e kandidatit në të kaluarën;
- Nivelin në të cilin kandidati i ka ushtruar kompetencat vendimmarrëse e drejtuese;
- Rezultatet e arritura në drejtim/menaxhim.

Anëtarët e Këshillit vlerësojnë gjithashtu argumentet dhe shpjegimet e kandidatit në letrën mbështetëse për këtë standard.

#### ***Standardi 3***

##### ***Eksperiencia në hartimin dhe miratimin e rregulloreve administrative (vlerësimi 0-3 pikë)***

Në letrën mbështetëse për këtë standard, kandidatët shpjegojnë sa dhe si janë përfshirë në hartimin dhe miratimin e rregulloreve administrative. Edhe ky standard duhet të dokumentohet nga ana e kandidatëve nëpërmjet akteve që vërtetojnë pjesëmarrjen e

tyre në grupe pune për hartimin dhe miratimin e rregulloreve të ndryshme apo akteve të tjera me karakter administrativ.

#### ***Standardi 4***

***Eksperienca në çështje të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike dhe ndërveprim me median (vlerësimi 0-3 pikë)***

Përveç letrës mbështetëse me shpjegimet përkatëse, lidhur me këtë standard, kandidatët mund të sjellin si dokumentacion provues, veç të tjerash edhe publikimet e ndryshme në media për çështje të hetuara apo përfaqësuara prej tyre të cilat kanë tërhequr vëmendjen e publikut dhe medias.

#### ***Standardi 5***

***Aftësitë në drejtimin efektiv të burimeve njerëzore (vlerësimi 0-3 pikë)***

Ky standard është i lidhur ngushtë me standardin 2 i cili vlerëson eksperiencat në drejtimin e një strukture, ku përfshihet edhe menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore. Kandidatët mund të dorëzojnë të njëjtin dokumentacion, duke theksuar që shërben për vlerësimin e dy standardeve. Së bashku me dokumentacionin, kandidatët dorëzojnë edhe letrën shpjeguese për këtë standard.

#### ***Standardi 6***

***Vizioni ose plani i besueshëm për ndërtimin e Prokurorisë së Posaçme si një institucion funksional dhe efektiv (vlerësimi 0-3 pikë)***

Për vlerësimin e këtij standardi, anëtarët e Këshillit bazohen në platformën e dorëzuar nga kandidatët sipas nenit 18 të rregullores dhe në prezantimin e saj në seancë dëgjimore. Drejtimet kryesore për vlerësimin e këtij standardi janë:

- qartësia dhe saktësia e platformës së paraqitur nga kandidati
- qartësia dhe saktësia e kandidatit në identifikimin dhe artikullimin e sfidave që paraqet ushtrimi i detyrës së drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme
- qartësia dhe saktësia e kandidatit në identifikimin dhe formulimin e ideve/planeve për adresimin e sfidave.

Lidhur me vlerësimin e këtij standardi, nuk është e nevojshme të paraqiten dokumente shtesë, përveç platformës së paraqitur në momentin e shprehjes së interesit.

### **Standardi 7**

#### ***Imazhi publik i karrierës së tij/saj si prokuror (vlerësimi 0-3 pikë)***

Kandidati edhe për këtë standard paraqet një letër mbështetëse. Lidhur me përmbushjen e këtij standardi, kandidatët mund të paraqesin çdo dokument i cili i shërben vlerësimit të imazhit të tyre si prokurorë, përfshi këtu edhe pjesë të vendimeve të organeve të rivlerësimit, vlerësime nga ana e eprorëve të tyre, vlerësime nga institucione apo organizata të ndryshme vendase apo të huaja etj.

#### **Shënim:**

***Letrat mbështetëse, platforma dhe dokumentacioni bashkëshoqërues si dhe prezantimi në seancën dëgjimore duhet të orientohen dhe të dëshmojnë aftësinë e kandidatit për të performuar me sukses në rolin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.***

## **IV**

### **Vlerësimi nga Këshilli**

Këshilli kryen intervistat me kandidatët në datën dhe renditjen e caktuar më parë. Pas përfundimit të këtij procesi secili nga anëtarët e Këshillit vlerëson kandidatët sipas formularit bashkëlidhur kësaj metodologjie. Për secilin standard kandidati merr 0-3 pikë. Maksimumi i pikëve që mund të grumbullojë një kandidat nga seci anëtar i Këshillit është 21.

Anëtari i Këshillit shpjegon masën e përmbushjes së secilit standard nga secili kandidat, vendos vlerësimin përkatës me pikë dhe e lexon atë në mbledhjen e Këshillit të caktuar për zgjedhjen e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Në përfundim realizohet votimi sipas nenit 148/dh, pika 3 të Kushtetutës, në mënyrë të hapur dhe nominale.

Secili nga anëtarët e Këshillit nuk mund të votojë më shumë se një kandidat.

**Formulari i vlerësimit për kandidatin \_\_\_\_\_**

Nr.	Përshkrimi i standardit	Vlerësimi shpjegues i anëtarit të Këshillit	Vlerësimi me pikë
1	Eksperiencia në ndjekjen e çështjeve sensitive të korrupsionit dhe krimit të organizuar.		
2	Eksperiencia dhe aftësitë në organizimin dhe drejtimin e një strukture		
3	Eksperiencia në hartimin dhe miratimin e rregulloreve administrative		
4	Eksperiencia në çështje të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike dhe ndërveprim me median		
5	Aftësitë në drejtimin efektiv të burimeve njerëzore		
6	Vizioni ose plani i besueshëm për ndërtimin e Prokurorisë së Posaçme si një institucion funksional dhe efektiv		
7	Imazhi publik i karrierës së tij/saj si prokuror		
<b>Totali</b>			

**ANËTARI I KËSHILLIT**  
(\_\_\_\_\_)